

SHQIPËRIA NË DOKUMENTET AUSTRO-HUNGAREZE

V I T I 1 9 1 4

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
Instituti i Historisë

**SHQIPËRIA NË DOKUMENTET
AUSTRO-HUNGAREZE**

(1914)

VËLLIMI VI

(korrik)

**Përgatitja dhe redaktimi
Akademik MARENGLLEN VERLI**

Tiranë, 2020

Drejtues i Projektit:

Akademik Marenglen VERLI

Akademik Vaso TOLE

Recensent:

Prof. dr. Valentina DUKA, Prof. dr. Ksenofon KRISAFI

Konfrontimi dhe korrektimi letrar:

Meliha BALLA

Radhitja:

Ylber HYSI, Meliha BALLA, Enkelejda MISHA

Arti Grafik & Treguesi i emrave:

Mirela MIHALI

MIRATUAR NË GRUPIN E PROJEKTIT

© Copyright: ASA - Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe përgatitësit

ISBN

ISBN

Botimet albanologjike

PARATHËNIE

Publikimi i dokumenteve historike për të kaluarën e shqiptarëve ka qenë dhe mbetet një detyrë e rëndësishme për historianët. Një gjë e tillë paraqitet veçanërisht e domosdoshme kur është fjala për ngjarje dhe dukuri me domethënie të jashtëzakonshme në historinë e shqiptarëve siç janë edhe ngjarjet e vitit 1914.

Viti 1914 është nga më të rëndësishmit në historinë moderne të kombit shqiptar. Ai nisi me përpjekjet e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit për të përcaktuar terrenin për ardhjen e Princ Wied-it në Shqipëri, vijoi me dy rebelimet që tronditën nga themelet shtetin e ri shqiptar dhe përfundoi me kthimin e vendit në fushë betejash dhe okupimin nga disa ushtri të huaja. Ngjarjet e muajve të fundit të vitit 1914, zhbënë atë që u arrit me shumë mund gjatë viteve 1912-1913, likuiduan Shqipërinë e pavarur dhe asnjëse.

Për vetë peshën që ngjarjet e këtij viti mbartin, ato kanë qenë dhe janë objekt i një vëmendjeje të veçantë në letërsinë historike shqiptare dhe të huaj. Krahas studimeve të mirëfillta, një vend të rëndësishëm në përpilimin e sfondit historik zënë edhe burimet dokumentare të arkivave të shteteve të huaja, politika e të cilëve ka qenë e lidhur drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me Shqipërinë e shqiptarët. Në këtë kuadër, dokumentet diplomatike austro-hungareze, janë një burim tejet i vlefshëm, në saje të të cilit ndriçohen deri në detaje lëvizjet politike e kulturore të shqiptarëve si dhe qëndrimi i faktorit ndërkombëtar ndaj çështjes shqiptare.

Në Arkivin e Institutit të Historisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, ruhet një fond i rëndësishëm i dokumenteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë (Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien).

Zgjedhja për botim e këtij fondi, nuk ka qenë e rastit.

Së pari, ky fond përbën një nga seksionet më të kompletuara të Arkivit të Institutit të Historisë. Ai ka filluar të formohet që në vitet 30 me prurjet

që synonin t'i shërbenin organizimit të festimeve të 25-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe u pasurua në përmasat që zotërojmë sot në vitet 50-70, nën kujdesin e posaçëm të prof. Aleks Budës. Dokumentet e këtij fondi i kemi në shqip në saje të punës së kujdesshme dhe tejet të përkushtuar të një grupi përkthyesish: Veniamin Dashi, Henrik Lacaj, Maksut Shehu, Aleksandër Hivziu, Shefqet Hoti, Bexhet Shehu, Pjetër Rodiqi, Tomor Dani, Sh. Koka, J. Nuraj etj.

Së dyti, diplomacia austro-hungareze e fillimshekullit ishte nga më aktivet në rajon, madje në një hark kohor prej disa dhjetërvjeçarësh, që përfshin edhe periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare edhe vitet pas Shpalljes së Pavarësisë deri në vitin 1918. E interesuar posaçërisht për Ballkanin, Perandoria Habsburgase shikonte me vëmendje të veçantë zhvillimet në trevat shqiptare ende nën sundimin osman, të cilat lakmoheshin nga shtetet e vogla ballkanike të krijuara përreth. Në këtë kuadër Perandoria ishte e pranishme me përfaqësi të shumta diplomatike në këto treva. Përveç ambasadës në Kostandinopojë, ajo kishte kryekonsullata në qendrat e katër vilajeteve shqiptare, përkatësisht Shkodër, Manastir, Janinë e Shkup dhe konsullata në shumë qytete të tjerë.

Së treti, raportet konsullore austro-hungareze dallohen nga pikëpamja e thellësisë dhe gjerësisë së informacionit historik që serviret. Dokumentet, natyrisht, kanë edhe nota subjektivizmi por përsëri informacioni që na përcjellin është shumë i vyer, aq më tepër për arsye se diplomatët e Vjenës ishin njerëz të mirëarsimuar, njohës të profesionit të vet, me shumë përvojë. Njëherësh ata kishin në dispozicion mjete të rëndësishme monetare, që u siguronin në terren njohje të gjera dhe informacione nga burime të rëndësishme vendase.

Së katërti, i rëndësishëm për t'u theksuar është fakti se ky informacioni mbulon tërë hapësirën shqiptare, madje edhe vendet fqinje, ndodhitë e të cilave lidhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me zhvillimet në vilajetet shqiptare. Një gjë e tillë shërben më së miri që lexuesit të krijojnë perceptime të sakta për ngjarje a dukuri të caktuara dhe më tej të qartësohen edhe për një kontekst më të gjerë të realitetit historik në vitin 1914.

Në dokumentet në fjalë gjenden të dhëna për tiparet e shqiptarëve, për virtytet dhe veset e tyre, madje sipas krahinave të ndryshme, mandej të dhëna për numrin dhe shtrirjen e tyre në planin etnik, për aftësitë e tyre, për nivelin e zhvillimit ekonomik, social, për aspiratat politike, për situatën arsimore e kulturore, për botimet në gjuhën shqipe, etj. Perandoria Dualiste ishte e interesuar të kishte një informacion për gjithçka, madje dhe për politikën e shteteve ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha me interesa në rajon,

sepse mbi këtë bazë ndërtonte politikën dhe mbronte interesat e saj gjeostrategjike.

Sa i përket vitit 1914, ky fond ka të dhëna me interes për ngjarje, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë lidhen me ardhjen dhe veprimtarinë e Princ Wied-it në Shqipëri si monark i shtetit të ri shqiptar, i njohur ndërkombëtarisht nga të gjithë Fuqitë e Mëdha, me rebelimet kundër tij, me fillimin e Luftës së Parë Botërore dhe me veprimet ushtarake në territorin e shtetit shqiptar etj. Në këtë kuadër jepen informacione interesante për lëvizjet politike të shqiptarëve, veprimet e armatosura në të gjitha trevat shqiptare, shqetësimin e ankthin, veçanërisht në elitën politike shqiptare për të mos humbur mbështetjen në radhët e faktorit ndërkombëtar dhe për të mbajtur larg ushtritë e fqinjëve etj. Në konstelacionin e zhvillimeve politike dhe ushtarake të kohës, lëvrijnë edhe një mori personalitetesh politike shqiptare dhe të huaja të niveleve të ndryshme.

Dokumentet e këtij vëllimi përfshijnë periudhën 1 korrik deri më 30 korrik 1914. Në to jepen informacione kryesisht për zhvillimin e kryengritjes antishtetërore në Shqipërinë e Mesme dhe të lëvizjes së ashtuquajtur “vorioepirote” në Shqipërinë e Jugut, për ndikimin e tyre në shkatërrimin e themeleve të shtetit shqiptar, për grupimet që morën pjesë në to, mbi qëndrimin e qeverisë shqiptare dhe të Princ Wied-it ndaj tyre, mbi qëndrimin që mbajtën krerë të ndryshëm shqiptarë dhe mbi pasojat e rënda që patën ato për kombin dhe shtetformimin në Shqipëri. Këto dokumente dëshmojnë gjithashtu edhe për pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë në prag të Luftës Botërore, pas vrasjes nga atentatorët serbë të trashëgimtarit të Fronit të Austro-Hungarisë, Franz Ferdinand-it, gjithashtu për politikën e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve fqinje ndaj Shqipërisë. Veçanërisht politika e Fuqive të Adriatikut, Italisë e Austro-Hungarisë zë një vend qendror në këtë vëllim. Ka informacione mbi veprimtarinë e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe qëndrimin e tij e të përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha ndaj situatës në Shqipëri. Gjithashtu pasqyrohet edhe veprimtaria e Komisionit për Caktimin e Kufirit Verior të Shqipërisë.

Të dhëna interesante përmban ky vëllim edhe për veprimtarinë e krerëve politikë shqiptarë si Ismail Qemali, Esat Pashë Toptani, Preng Bib Doda, Aziz Vrioni, Syrja Vlora etj.

Gjatë përgatitjes për botim është treguar një kujdes i veçantë që përmbajtja e dokumenteve të jepet e saktë, e qartë, duke e afruar gjuhën e përkthimit me atë letrare dhe duke ruajtur sa të ishte e mundur stilin e përkthyesit. Hera-herës është ndërhyrë edhe me shënime e sqarime plotësuese brenda në tekst ose në fund të tij. Dokumentet botohen të plota me përjashtim të rasteve kur teksti në origjinal ka qenë i palexueshëm ose i

fshirë, si edhe në ndonjë rast kur është vlerësuar se informacioni nuk ka pasur lidhje me botën shqiptare.

Së fundmi, është një kënaqësi t'u shprehet falënderim dhe mirënjohje studiuesve të gjeneratave të ndryshme të Institutit të Historisë, të cilët u angazhuan për pasurimin e fondeve të Arkivit të këtij Instituti me dokumentet diplomatike të Arkivit të Vjenës, si edhe, aktualisht me publikimin e tyre sipas kriterëve shkencorë bashkëkohorë. Një falënderim e nderim i veçantë u shkon edhe përkthyesve, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për sjelljen në shqip të dokumenteve që po shohin sot dritën e botimit.

Së fundi, nuk mund të mos përmendim angazhimin në kryerjen e një sërë procesesh të rëndësishme për përgatitjen e vëllimit për botim të znj. Meliha Balla, Mirela Mihali e Enkelejda Misha, të cilat meritojnë një falënderim të veçantë.

Përgatitësi

PASQYRA E LËNDËS

1.
Telegram i Ministrisë së Jashtme në Vjenë, drejtuar të ngarkuarit me punë, Egger, në Cetinë, lidhur me ankesat e kelmendasve
Vjenë, më 1 korrik 1914 79
2.
Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar përfaqësuesve diplomatikë në Romë, Paris, Stamboll, Peterburg dhe Durrës, lidhur me udhëtimin e Esat Pashës për në Paris; takimin e tij me emisarët xhonturq atje etj.
Vjenë, korrik 1914 79
3.
Telegram i Ministrisë së Jashtme në Vjenë, dërguar konsullatës austro-hungareze në Cetinë, me të cilin urdhëron që të zhvillohen hetimet ndaj shtetasit italian Felice Bertolini
Vjenë, më 1 korrik 1914 80
4.
Telegram i Ministrisë së Jashtme në Vjenë, dërguar ministrit austro-hungarez në Durrës, Lövental, për të bërë raportim lidhur me emërimin e baronit Bigelhen si kontrollor (drejtor) i policisë së Durrësit, nëse është emërim definitiv apo i përkohshëm etj.
Vjenë, më 1 korrik 1914 81
5.
Shkresë e Ministrisë së Luftës dërguar Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, për caktimin e Konstantin Bader me shërbim në Shkodër dhe Alois Fisher, kapiten kalorës i xhandarmërisë
Vjenë, më 1 korrik 1914 81

6. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Halla, në Shkodër, drejtuar ministrit të Jashtëm, Berchtold, për deklaratat e kolonelit Phillips mbi situatën në Durrës dhe projektin e krijimit të një ushtrie shqiptare
Shkodër, më 1 korrik 1914 83
7. Shkresë e Ministrisë së Luftës dërguar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, mbi dhënien e meshës për detashmentin ushtarak në Shkodër dhe kërkesën që kisha e françeskanëve të caktohet si kishë garnizoni në Shkodër
Vjenë, më 1 korrik 1914 84
8. Telegram i Ministrisë së Jashtme në Vjenë, dërguar ambasadorit Mérey në Romë dhe të dërguarit në Athinë, Szilassy, mbi memorandumin e ambasadës mbretërore britanike në Vjenë, me anë të të cilit Londra autorizon të dy këta diplomatë të bëjnë hetime për vërtetësinë e veprimeve antihumane të qeverisë greke
Vjenë, më 1 korrik 1914 85
9. Buletin ditor i Ministrisë së Jashtme në Vjenë, drejtuar gjithë ambasadave në Europë – legatave dhe konsullatave në Ballkan, ku pasqyrohet nota e ambasadorit mbretëror të Britanisë së Madhe, në lidhje me forcën e ushtrisë shqiptare
Vjenë, më 1 korrik 1914 86
10. Shkresë e drejtorisë së shtëpisë botuese perandorake e mbretërore të librit shkollor në Vjenë, dërguar Ministrisë së Jashtme, departamentit politik në Vjenë, për shtypjen e librave të leximit shqip sipas porosive të bëra
Vjenë, më 1 korrik 1914 87
11. Relacion i konsullit të Përgjithshëm në Shkodër, Halla, dërguar ministrit Fuqiplotë në Durrës, Lövental, mbi vizitën e Basri Beut në Durrës dhe marrjen e masave për sigurinë fizike të tij
Shkodër, më 1 korrik 1914 88
12. Raport i konsullit në Shkodër, Halla, dërguar ministrit të Jashtëm, Berchtold, mbi letrën e dr. Selimit nga Shkodra që ndodhet për kurim në një spital të Napolit dhe mbi takimet e tij me Esat Pashën 88

- Shkodër, më 1 korrik 1914* 88
13. Telegram i nënkonsullit Mayerhauser, në Vlorë, dërguar minsistrit të Jashtëm, kontit Berchtold në Vjenë, lidhur me ligjin e dënimit me vdekje
Vlorë, më 1 korrik 1914 89
14. Telegram i ambasadorit Mérey në Romë, dërguar Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, mbi gostitë e shtruara nga pala italiane gjatë pritjes së personaliteteve shqiptare dhe për mosthirrjen e ambasadorit austro-hungarez në Romë
Romë, më 1 korrik 1914 90
15. Telegram i ambasadorit Mérey në Romë, dërguar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, ku bën të ditur shtyrjen e datës së nisjes së Turhan Pashës për në Vjenë
Romë, më 1 korrik 1914 90
16. Letër e piktorit austriak Georg Shilling në Zvicër, dërguar Ministrisë së Luftës, në Vjenë, me të cilën kërkon të regjistrohet si vullnetar për në Shqipëri
Zyrih, Florastrasse, më 2 korrik 1914 91
17. Telegram i Komandës së Flotës së Kryqëzorëve nëpërmjet bazës navale Kastelnuovo, dërguar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, për marrjen e të hollave nga Marka Gjoni, si dhe për qëndrimin e Mirditës dhe të Beratit ndaj qeverisë
Vjenë, më 2 korrik 1914 92
18. Raport i nënkonsullit austro-hungarez në Prizren, Kohlruss, dërguar ministrit të Jashtëm në Vjenë, mbi insinuatat serbe në Lumë dhe në Has dhe për inskenimin e një kryengritjeje në Has në favor të Esat Pashës
Prizren, më 2 korrik 1914 92
19. Notë e ambasadës gjermane në Vjenë, dërguar Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, me të cilën kërkon të dijë lidhur me projektligjin kushtetues të Shqipërisë
Vjenë, më 2 korrik 1914 94

20.
Telegram i Ministrisë së Jashtme në Vjenë, dërguar ministrave të akredituar në Athinë Szilassy, dhe në Durrës Lövental, ku bëhet e ditur se përfaqësuesit e Austro-Hungarisë dhe Italisë në Athinë janë të autorizuar për t'i tërhequr vërejtjen udhëheqësve epirotë
Vjenë, më 2 korrik 1914 95
21.
Telegram i ministrit të Jashtëm kontit Berchtold, dërguar përfaqësuesve diplomatikë në Stamboll, Berlin, Romë, Londër, St. Peterburg, Paris dhe Durrës, me anë të të cilit iu bën të ditur "Marrëveshjen e Korfuzit" e cila vlen edhe për konsullin e Përgjithshëm, Kral në Vlorë
Vjenë, më 2 korrik 1914 95
22.
Notë e Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, drejtuar ambasadës së Britanisë së Madhe, në Vjenë, mbi një demarsh pranë qeverisë greke, dhe dhënien e autorizimit të dërguarit perandorak e mbretëror në Athinë, që të intervenojë pranë kabinetit grek
Vjenë, më 2 korrik 1914 96
23.
Telegram i ministrit të Jashtëm në Vjenë, dërguar kolonelit Mietzl në Guci dhe Mérey-t në Romë, mbi dhënien e lejes për përdorimin e armëve kelmendasve
Vjenë, më 2 korrik 1914 97
24.
Telegram i qendrës Pola, dërguar Ministrisë së Luftës – Seksioni i Marinës në Vjenë, për lëvizjen e torpedinierëve nga Pola në Durrës dhe anasjelltas
Vjenë, më 2 korrik 1914 98
25.
Telegram i Ministrisë së Luftës – Seksioni i Marinës në Vjenë, dërguar Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, për hyrjen në limanin Teodo të anijes, "St. Georgu"
Vjenë, më 2 korrik 1914 98
26.
Telegram i Komandës së flotilës së kryqëzorëve nga Kastelnuovo, dërguar Ministrisë së Luftës – Seksioni i Marinës, Vjenë, mbi nisjen e anijes "St. Georgu" për furnizime
Vjenë, më 2 korrik 1914 99

27. Shkresë e Drejtorisë së Botimeve të Librave Shkollorë, në Vjenë, dërguar Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, ku njofton botimin e librave me vlerat përkatëse
Vjenë, më 2 korrik 1914 99
28. Letër e delegatit italian të Komisionit të Caktimit të Kufirit të Shqipërisë, kolonel Marafini, në Vermosh, dërguar Jak Serreqit, me Jesnicë, në të cilën vihet në dijeni se qeveria e Malit të Zi i lejon kelmendasit të kullosin bagëtitë e veta në tokat e tyre dhe se nuk do t'i nënshtrohen asnjë takse etj.
Vermosh, më 2 korrik 1914 100
29. Telegram i ambasadorit Mérey në Romë, dërguar ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold në Vjenë, mbi kthimin e një shkrese të Seksionit të Marinës, për raportin e ngjarjeve të periudhës 24-31 maj 1914
Romë, më 2 korrik 1914 101
30. Telegram i zëvendëskonsullit Hornbostel, në Janinë, dërguar Kastelnuovo – Durrës për mosardhjen e tri agentëve atje
Durrës, më 2 korrik 1914 102
31. Raport i konsullit të Përgjithshëm Halla, në Shkodër, dërguar ministrit të Jashtëm kontit Berchtold, në Vjenë, mbi mbledhjen e fuqive të armatosura të Preng Bib Dodës në Lezhë e Mirditë, si dhe refuzimin e myslimanëve të Shkodrës dhe të Postribës për të dërguar vullnetarë kundër rebelëve në Shqipërinë e Mesme etj.
2 korrik 1914 102
32. Shkresë e konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Milano, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, në Vjenë, bashkëlidhur dhe 3 kopje të broshurës “Il commercio italiano e l’opposta sponda adriatica”, me autor Leonardo Acarita, në të cilën boton përshtypjet e veta mbi vizitën studimore në Shqipëri dhe Malin e Zi
Milano, më 2 korrik 1914 105

33.
 Korrespondencë e ambasadorit Mérey, në Romë, dërguar ministrit të Jashtëm, në Vjenë, mbi favorizimet për eksportin italian në Shqipëri, botuar në "Postën javore" të Triestes
Romë, më 2 korrik 1914 106
34.
 Njoftim i përfaqësuesit të legatës austro-hungareze Streit, në Athinë, dërguar Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, me të cilën vë në dijeni se i ka njoftuar qeveritë respektive të gjashtë Fuqive mbi aprovimin e marrëveshjes në Korfuz nga ana e KNK-së dhe delegatëve epirotë për statusin e ardhshëm të Epirit
Athinë, më 2 korrik 1914 107
35.
 Telegram i ministrit të Jashtëm në Vjenë, dërguar Lövental-it, në Durrës, me të cilin e porositi, që ta mbajë në korent lidhur me qëndrimin e Ismail Qemalit në Durrës
Vjenë, më 2 korrik 1914 107
36.
 Raport i zëvendëskonsullit Kohlruß në Prizren, dërguar kontit Leopold Berchtold në Vjenë, me të cilin raporton për festimin e ditës përkujtimore të luftës në Fushë-Kosovë të vitit 1389
Prizren, më 2 korrik 1914 108
37.
 Telegram i ministrit të Jashtëm Berchtold, në Vjenë, dërguar ambasadotit Mérey në Romë dhe konsullit të Përgjithëm Kral, në Durrës, me të cilin interesohet të dijë nëse e konsideron të mundshëm një vendim të Komisionit të Kontrollit për largimin e De Weer-it nga posti
Vjenë, më 3 korrik 1914 109
38.
 Shkresë e Ministrisë së Jashtme të Serbisë, dërguar Ministrisë së Luftës, mbi aktivitetin e disa personave, që do të mbërrinin në Durrës, si dhe përçapjet e legatave serbe, që bëjnë përçapje për ndalimin e importimit të armëve në Shqipëri
Beograd, më 3 korrik 1914 109

39. Shkresë e Ministrisë së Jashtme të Serbisë, dërguar Ministrisë së Luftës, mbi urdhrin konfidencial të Ljubović-it, për furnizimin me municion të kryetarit të rrethit të Dibrës në rast sulmi nga kryengritësit etj.
Beograd, më 3 korrik 1914 110
40. Telegram i qendrës Pola në Kotorr, dërguar Ministrisë së Luftës, në Vjenë, me të cilin njofton lëvizjet e anijeve në Durrës dhe Kotorr
Vjenë, më 3 korrik 1914 112
41. Kopja e një urdhri të Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar përfaqësuesit diplomatik Egger, në Cetinë, me të cilin e urdhëron që të mbajë qëndrim ndaj qeverisë malazeze për dhunimin e kufirit afër Gjakovës
Vjenë, më 3 korrik 1914 112
42. Shkresë e ministrit rezident në Durrës, Lövental, dërguar ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold, në Vjenë, në të cilën i parashtron një kopje të letrës që rebelët i kanë drejtuar popullit të Beratit
Durrës, më 3 korrik 1914 113
43. Telegram i ministrit të Jashtëm Berchtold, në Vjenë, dërguar Lövental-it, në Durrës dhe Mérey-t, në Romë, me të cilin porosit që të vihet në dijeni tepër konfidencialisht markeze di San Giuliano se afrimi i vullnetarëve europianë mund ta përmirësojë pozitën jo të mirë të princ Wied-it
Vjenë, më 3 korrik 1914 113
44. Raport i konsullit Halla, në Shkodër, dërguar ministrit të Jashtëm, Berchtold, në Vjenë, mbi ngjarjet e ndodhura në kampin e Preng Bib Dodës, gjatë marshimit me forcat e tij në drejtim të Durrësit dhe Ishmit kundër kryengritësve
Shkodër, më 3 korrik 1914 114
45. Raport i konsullit Halla, në Shkodër, dërguar ministrit të Jashtëm Berchtold, në Vjenë, mbi tërheqjen e Preng Bib Dodës nga Ishmi, intrigat italiane dhe akuzat për korruptimin e tij nga italianët me qëllim që të tërhiqet dhe kjo fushatë të dështojë
Shkodër, më 3 korrik 1914 116

46. Shtojca e raportit të konsullit Halla, në Shkodër, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, në të cilën jepet sasia e materialeve ushtarake të Preng Bib Dodës
Shkodër, më 3 korrik 1914 119
47. Raport i konsullit Halla, në Shkodër, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, mbi lajmet e përhapura për kthimin e Esat Pashës në Shqipëri, të pavërtetuar e me gjasë të shkaktuara nga ardhja e sekretarit privat të Pashës në Cetinë, me destinacion për në Tiranë, etj.
Shkodër, më 3 korrik 1914 119
48. Kopje e një raporti të nënkonsullit Mayerhauser, në Vlorë, dërguar ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold, për ngjarjet në Berat
Vlorë, më 3 korrik 1914 120
49. Raport i ambasadorit Mensdorff, në Londër, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, lidhur me diskutimet në Odën e Komuneve, që iu kushtuan edhe Shqipërisë; qëndrimi kundërshtues i Edward Grey-t për krijimin e konsullatave në Shqipëri; deklarata e E. Grey-t për mosdërgimin e trupave ushtarake analoge në Shqipëri për të intervenuar në Epir
Londër, më 3 korrik 1914 121
50. Telegram i ministrit të Jashtëm, në Vjenë, dërguar përfaqësuesve diplomatikë austro-hungarezë në Berlin, Peterburg, Londër, Paris, Bukuresht, Romë dhe Durrës, lidhur me dërgimin e trupave rumune në Shqipëri
Vjenë, më 3 korrik 1914 123
51. Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Berlin, Szögyenyi, dërguar Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, mbi një njoftim të Ministrisë së Jashtme gjermane, se Turhan Pasha do t'u deklarojë qeverive të Romës dhe Vjenës, që pa ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha, mbajtja e *status quo*-së në vend duket e pamundur
Berlin, më 3 korrik 1914 124
52. Letër e kryetarit të së ashtuquajturës qeveri e Vorio-Epirit, Jorgji Zografos, në Gjirokastrë, dërguar kryetarit të Komisionit të Kontrollit August Kral, në

- Durrës, me të cilën kërkon që qeveria e princ Wied-it dhe Komisioni i Kontrollit të përfundonin një marrëveshje mes tyre, me qëllim që Asamblea epirote që do të mbledhet në Gjirokastër, të ratifikojë vendimet e Korfuzit
Gjirokastër, më 3 korrik 1914 124
53. Raport i zëvendëskonsullit Kohlruss, në Prizren, dërguar ministrit të Jashtëm Berchtold, në Vjenë, për rikthimin e myslimanëve nga Shqipëria në rajonin konsullor të Prizrenit
Prizren, më 3 korrik 1914 125
54. Telegram i Komandës së flotilës së kryqëzorëve me anë të bazës në Kastelnuovo, dërguar Ministrisë së Luftës në Vjenë, mbi vendimin e Këshillit të Ministrave, për t'i njoftuar Turhan Pashës që të kërkojë ndihmë ushtarake nga Roma dhe Vjena
Vjenë, më 3 korrik 1914 126
55. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Selinë e Shenjtë, Schönburg, dërguar ministrit të Jashtëm, Berchtold në Vjenë, në të cilin parashtron pikëpamjet e Vatikanit mbi pozitën e tanishme të Protektoratit në Shqipëri
Vatikan, më 4 korrik 1914 127
56. Telegram i nënkonsullit Mayerhauser, në Vlorë, dërguar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, lidhur me verifikimin e Akile Arkentit dhe të dy shokëve të tij, nëse kanë qenë në Vlorë
Vlorë, më 4 korrik 1914 130
57. Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar konsullatës së Përgjithshme në Shkodër, në të cilin bashkëngjitet ekstrakti i notës së Ministrisë së Luftës, lidhur me përdorimin e oficerëve austro-hungarezë në Shkodër, për të cilët kërkohet raportim nëse janë pranuar
Vjenë, më 4 korrik 1914 130
58. Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, për ministrin e akredituar në Athinë, Szilassy, me të cilin përshëndet mendimin e zotit Streit se epirotët mbajnë anën e princit dhe të Komisionit të Kontrollit dhe se po të qe nevoja ata do të luftonin kundër rebelëve
Vjenë, më 4 korrik 1914 132

59.
Raport i ambasadorit austro-hungarez në Paris, Szécsen, dërguar ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold, në Vjenë, lidhur me opinionin e Francës mbi situatën në Shqipëri
Paris, më 4 korrik 1914 132
60.
Relacion i komandës së trupave serbe në Shkup, dërguar Ministrisë së Luftës së Serbisë, lidhur me luftimet mes kryengritësve dhe forcave të Wied-it në Shqipërinë e Mesme, numrin e forcave, armatimet si dhe bilancet e luftimeve
Shkup, më 4 korrik 1914 134
61.
Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar përfaqësuesve diplomatikë në Durrës, Shkodër, Guci dhe Cetinë, mbi lejimin e kalimit të banorëve të Kelmendit për në kullotat e Vermoshit, me porosi që përfaqësuesit të provokonin një vendim të ri të KNK-së në favor të Kelmendit
Vjenë, më 4 korrik 1914 135
62.
Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar ambasadorit në Romë, Mérey-t, me porosinë që të njoftohet San Giuliano me tekstin e telegramit për të urdhëruar stacionarët që të ndalojnë importimin e paautorizuar të armëve
Vjenë, më 4 korrik 1914 136
63.
Telegram i ministrit të Jashtëm, Berchtold, dërguar Lövental-it në Durrës, në të cilin flitet për pozicionimin politik të Mirditës në rrethanat e reja, veprimet e mirditasve në Shijak, si edhe nevojën që për të gjitha këto të informohet imzot Doçi, i cili ndodhej në Durrës
Vjenë, më 4 korrik 1914 137
64.
Raport i ministrit Szilassy, të akredituar në Athinë, dërguar kontit Berchtold, ku parashtrohet luajaliteti i qeverisë greke në çështjen epirote dhe ku rebelizmat në Shqipëri vlerësohen si vepër e xhonturqve dhe e qeverisë greke
Athinë, më 4 korrik 1914 138

65.
Telegram i Komandës së flotilës së kryqëzorëve me anën e bazës navale në Kastelnuovo, dërguar Ministrisë së Luftës, mbi urdhërimin e Preng Bib Dodës për t' u kthyer tek princi në Durrës
Kastelnuovo, më 4 korrik 1914 140
66.
Telegram i Ministrisë së Jashtme në Vjenë, dërguar përfaqësive diplomatike në Londër, Paris, Romë, Berlin, Peterburg, Stamboll, Bukuresht dhe Durrës, me të cilin porosit që, sapo kolegu italian në Bukuresht të marrë autorizim analog, përfaqësuesi në Bukuresht të nxitë qeverinë rumune të dërgojë trupa ushtarake në Shqipëri, ndërsa përfaqësuesi diplomatik në Stamboll të protestojë pranë Portës, për ndihmën ndaj rebelëve në Shqipëri
Vjenë, më 4 korrik 1914 141
67.
Buletin ditor i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, ku jepen të dhëna mbi bisedimet midis ministrit të Jashtëm italian, markezit San Giuliano dhe Turhan Pashës
Vjenë, më 4 korrik 1914 142
68.
Raport i nënkonsullit Kohlruss në Prizren, dërguar ministrit të Jashtëm, Berchtold, në Vjenë, në të cilin trajton gjendjen politike të brendshme në krahinat kufitare të Shqipërisë, dhe mbi kundërshtimin e gjithë muhtarëve e imamëve për të mos ndërhyrë dhe kundërvënë myslimanët kundër njëri-tjetrit
Prizren, më 5 korrik 1914 143
69.
Raport i konsullit të Përgjithshëm Halla, në Shkodër, dërguar ministrit të Jashtëm, Berchtold, në Vjenë, lidhur me leximin e meshës për trupat e detashmentit austro-hungarez në kishën e françeskanëve në Shkodër
Shkodër, më 5 korrik 1914 144
70.
Notë e ambasadorit gjerman Ditrih Berman - Holveg, në Vjenë, dërguar ministrit të Jashtëm austro-hungarez, Berchtold, mbi njoftimin e qeverisë greke rreth miratimit të marrëveshjes së Korfuzit nga Gjermania dhe Austro-Hungaria
Vjenë, më 5 korrik 1914 146

71.
Telegram i ministrit austro-hungarez në Durrës, Lövental, dërguar në Kastelnuovo, me të cilin kërkon që të blihen urgjentisht 200 ekzemplarë të gazetës “Pejami” që po botohet në Stamboll
Durrës, më 5 korrik 1914 146
72.
Raport i diplomatit austro-hungarez në Mitrovicë, Umlauf, dërguar Ministrisë së Luftës dhe Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, mbi lëvizjen e trupave dhe transport ushqimesh e materialesh ushtarake nga Shkupi në Novipazar
Mitrovicë, më 5 korrik 1914 147
73.
Raport i ministrit austro-hungarez në Durrës, Lövental, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, në të cilin pasqyron ambiciet dhe intrigat e Esat Pashës, lidhur me qëndrimin ndaj princit, si para dhe pas ardhjes së tij, lojën me italianët, qëndrimet për luftën ndaj kryengritësve epirotë dhe atyre të Shqipërisë së Mesme, rolin e tij në këtë të fundit dhe tentativën e italianëve për ta larë atë nga mëkatet etj.
Durrës, më 5 korrik 1914 148
74.
Raport i ministrit austro-hungarez në Durrës, Lövental, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, në të cilin pasqyrohet çështja e kolonel Muricchio-s dhe qëndrimi i diplomatit italian për akuzat ndaj tij mbi sinjalet me drita për rebelët
Durrës, më 5 korrik 1914 151
75.
Telegram i Zografosit, dërguar nga Gjirokastra kryetarit të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, August Kral, në Durrës, me të cilin me nota dramatike përshkruan gjendjen e të krishterëve në qytetin e Korçës, të cilët, sipas tij, kërcënohen e persekutohen dhe kërkon marrjen e masave për të mbrojtur truallin epirot
Gjirokastër, më 5 korrik 1914 152
76.
Radiogram i ministrit austro-hungarez të akredituar në Durrës, Lövental, dërguar Turhan Pashës nëpërmjet Kastelnuovos në Vjenë, me të cilin i bën komunikimin e autorizimit të princit August, që të vizitojë gjithë kryeqytetet e Fuqive të Mëdha 152

- Durrës, më 5 korrik 1914* 152
77.
Telegram i Komandës së Flotës së Kryqëzorëve nëpërmjet Bazës Kastelnuovo, në Kotorr, dërguar Ministrisë austro-hungareze të Luftës, Seksionit të Marinës, në Vjenë, me të cilin njofton mbërritjen e vullnetarëve gjermanë
Kastelnuovo, Kotorr, më 5 korrik 1914 153
78.
Ditar i Komisionit të Caktimit të Kufirit të Shqipërisë së Veriut, nga data 25 qershor 1914 deri më 6 korrik 1914
6 korrik 1914 153
79.
Telegram i Ministrisë së Jashtme në Vjenë, dërguar përfaqësive diplomatike në Vlorë, Durrës dhe Shkodër, me të cilin porositi që të verifikohet një lajm, sipas të cilit, disa agentë italianë kanë ardhur në Shqipëri
Vjenë, më 6 korrik 1914 162
80.
Raport i komisarit pranë KNK-së Kral, në Durrës, dërguar ministrit të Jashtëm austro-hungarez në Vjenë dhe ambasadave, lidhur me qëllimin e Zografos-it dhe qëndrimin e Greqisë për marrëveshjen e Korfuzit
Durrës, më 6 korrik 1914 162
81.
Shkresë e të dërguarit austro-hungarez në Athinë, Szilassy, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, në të cilën bashkëngjit tekstin e ligjit mbi cedimin e ishullit të Sazanit
Athinë, më 6 korrik 1914 164
82.
Shkresë konfidenciale e Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar kontit Tisza, në Budapest, lidhur me blerjen e një çifligu në Pasha Liman nga austro-hungarezët
Vjenë, më 6 korrik 1914 165
83.
Telegram i kontit Berchtold, në Vjenë, për diplomatin austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, mbi kujdesin për blerjen e 200 kopjeve të gazetës "Pejani" të datës 28 qershor, të cilat t'i dërgohen Lövental-it, në Durrës
Vjenë, më 6 korrik 1914 166

84. Raporti buxhetor i Ministrisë së Kultit e Arsimit në Vjenë, dërguar këshilltarit të qeverisë, mbi blerjen e mjeteve mësimore për shkollën hekurudhore në Shkup
Vjenë, më 6 korrik 1914 166
85. Aktnjohim i Ministrisë së Kultit e të Arsimit, në Vjenë, dërguar Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, për vënien në dispozicion të kësaj ministrie të mjeteve mësimore për shkollën në Shkup
Vjenë, më 6 korrik 1914 167
86. Raport i konsullit austro-hungarez, Adamkiević, dërguar nga Shkupi Ministrisë së Luftës dhe ministrit të Jashtëm, Berchtold, lidhur me ngjarjet e ndodhura gjatë datave 25 qershor deri më 5 korrik 1914, për lëvizjen e trupave dhe mjeteve ushtarake serbe
Shkup, më 6 korrik 1914 167
87. Raport i ministrit austro-hungarez të akredituar në Durrës, Lövental, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, lidhur me akuzat kundër Greqisë për kryengritjen e Shqipërisë së Mesme dhe lëvizjen epirote
Durrës, më 6 korrik 1914 170
88. Telegram i Komandës së skuadriles së Marinës, në Fiume, dërguar Ministrisë së Luftës, Seksionit të Marinës, në Vjenë, me të cilin njoftohet nisja për në Durrës e dy oficerëve dhe të 60 vullnetarëve rumunë me vaporin "Godolo"
Vjenë, më 6 korrik 1914 172
89. Shtojcë e raportit të ministrit të akredituar në Durrës, Lövental, dërguar ministrit të Jashtëm në Vjenë, Berchtold, lidhur me njoftimin e Mehdi Frashërit për kapjen rob të një ushtari grek në Korçë, i cili deklaroi se ishte i detyruar nga oficerët për të hyrë në Batalionin e Shenjtë
Durrës, më 6 korrik 1914 172
90. Raport i legatës në Athinë, dërguar kontit Berchtold në Vjenë, lidhur me deklaratat e ministrit amerikan Williams, mbi intrigat greke në Vlorë si dhe nxitjen e "epirotëve" për kryengritje 173

- Athinë, më 6 korrik 1914* 173
91. Raport i konsullit Para, në Korfuz, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, për situatën në Epir, lëvizjet e Zografos dhe Karapanos drejt Gjirokastrës, për marrëveshjen e Korfuzit, si dhe për të përgatitur terrenin për qëllime eventuale të qeverisë greke etj.
Korfuz, më 6 korrik 1914 173
92. Përgjigje telegrafike e kryetarit të Komisionit të Kontrollit, Kral, në Durrës, dërguar Zografos-it, në Gjirokastrë, me të cilin i përgënjeshton njoftimet e tij për gjoja gjendjen kërcënuese ndaj popullsisë së krishtere në Korçë
Durrës, më 6 korrik 1914 174
93. Letër e krerëve të tri bajraqeve të Selcës, Nikshit dhe të Vuklit me gjithë banorët e Kelmendit, dërguar kryetarit të Komisionit të Kontrollit, Kral, në Durrës, me të cilin i kërkojnë përkrahjen dhe mbështetjen e Komisionit të Kontrollit për kërkesat e tyre pranë Fuqive të Mëdha dhe Malit të Zi, për të lënë të lirë kalimin e këtyre banorëve në kullotat e tyre në Vermosh dhe në tregun e Gucisë, si dhe për largimin e ushtrisë malazeze nga Vermoshi
Selcë, më 6 korrik 1914 175
94. Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar Mérey-t, në Romë, ku bën të ditur se do t'i dërgojë përmbajtjen e bisedës midis markezit San Giuliano-s dhe Turhan Pashës
Vjenë, më 6 korrik 1914 176
95. Shtojcë e raportit të ambasadës austro-hungareze në Romë për Ministrinë e Jashtme në Vjenë, që përmban kopjen e raportit të konsullit Pflugel, në Napoli, me lajmin për nisjen e Esat Pashës në Paris
Napoli, më 7 korrik 1914 177
96. Komunikatë e zyrës së shtypit të "Epirit autonom", transmetuar nga Delvina me telegram, lidhur me deklaratën e Zografos, që përgënjeshton lajmin e shtypit të huaj, se ushtria helenike ka marrë pjesë në pushtimin e Korçës, dhe se ushtria epirote ka bashkëpunuar me myslimanët
Delvinë, më 7 korrik 1914 177

97.
Telegram i kontit Berchtold, dërguar përfaqësive diplomatike në Peterburg, Berlin, Paris, Londër dhe Romë, mbi turneun e Turhan Pashës nëpër kryeqytetet e Fuqive të Mëdha
Vjenë, më 7 korrik 1914 179
98.
Informacion i ambasadorit Mensdorff në Londër, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, lidhur me interpelancën në Dhomën e Lordëve për dërgimin e trupave angleze në Shqipëri
Londër, më 7 korrik 1914 180
99.
Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar konsullatës austro-hungareze në Durrës, lidhur me një korrespondencë për çështjet shqiptare, me botues Leo Freundlich, në Vjenë, në të cilën trajton shkresën e Syrja Beut dërguar Mbretëreshës së Rumanisë për nevojën e trupave rumune, në ndihmë të princit të Shqipërisë
Vjenë, më 7 prill 1914 180
100.
Njoftim i përfaqësuesve të Komitetit të mbrojtjes në Shqipërinë e Jugut, dërguar Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, në Durrës, me të cilin përgënjeshtrohet akuzat e Zografos-it ndaj shqiptarëve
Gjirokastër, më 7 korrik 1914 181
101.
Përgjigje letrës së përfaqësuesve të gjashtë Fuqive të Mëdha nga kryengritësit e Shijakut, me të cilën u kërkojnë që ata të vijjnë t'i takojnë, për t'u njohur me gjendjen dhe kërkesat e tyre
Shijak më 7 korrik 1914 182
102.
Telegram i detashmentit austro-hungarez në Shkodër, dërguar zyrës së Presidiumit të Ministrisë së Luftës dhe Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, për sulmin ndaj stacionit të radios dhe rojes në drejtim të Bardhajt, të një grupi kundërshtarësh prej 100 myslimanë, të cilët u zbrapsën nga forcat e policisë dhe milicisë austro-hungareze
Shkodër, më 7 korrik 1914 183
103.
Shkresë e Geoklit-it dërguar firmës "Post ekspedicion" në Vjenë, lidhur me shtypjen e 2000 kopjeve të gramatikës shqipe, pjesa I 184

- Vjenë, më 7 korrik 1914 184
104. Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme, dërguar drejtorisë së shtëpisë botuese austro-hungareze në Vjenë, me të cilën i kërkon që të bëhet propozimi për shtypjen e teksteve shkollore shqipe
Vjenë, më 7 korrik 1914 185
105. Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme, në Vjenë, dërguar Drejtorisë së Botimit të librit shkollor, në Vjenë, lidhur me udhëzimet për botimin e librit të këndimit shqip
Vjenë, më 7 korrik 1914 185
106. Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar Lövental-it në Durrës, me të cilin bën të ditur akt-delegimin, që Syrja Beu i jep Eqrem Beut, mbi fillimin e tratativave për shitjen e pronës së tij në Pasha Liman
Vjenë, më 7 korrik 1914 186
107. Informacion i konsullit Halla, në Shkodër, dërguar ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold, në Vjenë, me të cilin i parashtron lutjen e famullitarit Serreqi në Selcë, për lënien e lirë të kalimit të banorëve nëpër Krapsh për në Vermosh, nga forcat malazeze
Shkodër, më 7 korrik 1914 186
108. Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar kolonelit Mietzl, në Shkodër, me të cilin njoftohet se i dërgohet bashkëlidhur skica e hartës për Vermoshin dhe Taraboshin
Vjenë, më 7 korrik 1914 187
109. Informacion konfidencial i konsullit Para, në Korfuz, dërguar ministrit të Jashtëm kontit Berchtold, në Vjenë, lidhur me demarshet e qeverisë italiane në Athinë, për të ndalur kërcënimin eventual të Vlorës nga ana greke
Korfuz, më 7 korrik 1914 188
110. Informacion i delegatit austro-hungarez, kolonelit Mietzl, në Vunsaj, dërguar Ministrisë së Jashtme dhe asaj të Luftës, në Vjenë, me të cilin njofton se ekzemplari origjinal i ditarit dhe gjithë dërgesa postare u humbën nga gjeodeti në rrugën Guci-Lugina e Vermoshit 189

- Vunsaj, më 7 korrik 1914* 189
111.
Njoftim urgjent i Ministrisë së Luftës, në Vjenë, dërguar Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, lidhur me instruksionet për fuqitë e armatosura të detashmentit të caktuar për Komisionin e Caktimit të Kufirit Verior të Shqipërisë në rast të një mobilizimi
Vjenë, më 7 korrik 1914 189
112.
Telegram nga Tetova për Ministrinë e Jashtme, dërguar Ministrisë së Brendshme, lidhur me një informacion se në Shqipëri po bëhen përgatitje për një mësymje kundër Serbisë
Tetovë, më 7 korrik 1914 190
113.
Raport i konsullit Halla, dërguar nga Shkodra ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold, lidhur me qëndrimin pro austriak të Preng Bib Dodës, influencën e tij në popullsinë katolike të Veriut, nevojat e tij financiare etj.
Shkodër, më 7 korrik 1914 191
114.
Raport i të diplomatit austro-hungarez në Bulkelei [Kajro], dërguar ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold në Vjenë, lidhur me aspiratat e Princit Fuad për fronin e Shqipërisë
Bulkelei, më 8 korrik 1914 194
115.
Shkresë e Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, dërguar Ministrisë së Arsimit dhe firmës "Pichler's & Bohu" në Vjenë, lidhur me dërgimin e librave shqip dhe të hartës gjeografike të Europës, shkollës në Prizren
Vjenë, më 8 korrik 1914 195
116.
Telegram i Komandës së flotës së kryqëzorëve të bazës së Kastelnuovos, dërguar Ministrisë së Luftës - Seksionit të Marinës, në Vjenë, me të cilin i njofton mbërritjen në Shqipëri të 60 kosovarëve, 45 vullnetarëve rumunë dhe tre oficerëve
Vjenë, më 8 korrik 1914 196
117.
Telegram i konsullit Halla në Shkodër, dërguar përfaqësisë austro-hungareze në Durrës, dhe komisarit Kral, me të cilin njofton nisjen e Irfan Beut për në Mal të Zi 197

- Shkodër, më 8 korrik 1914* 197
118. Raport i konsullit Halla, në Shkodër, dërguar ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold, lidhur me udhëtimin e krerëve të partisë Esatiste për në Malin e Zi dhe prej andej tek kryengritësit e Shqipërisë së Mesme
Shkodër, më 8 korrik 1914 197
119. Shtojca e raportit dhe telegrami i Ministrisë së Luftës, Seksioni i Marinës, në Vjenë, dërguar konsullatës në Vlorë, për ndalimin e paautorizuar të armëve dhe njoftimin e Komandës së flotilies
Vjenë, më 8 korrik 1914 198
120. Telegram i Komandës së flotës së kryqëzorëve, në Kastelnuovo, dërguar Ministrisë së Luftës, Seksionit të Marinës, për mbërritjen e 150 kosovarëve dhe vullnetarëve gjermanë
Vjenë, më 8 korrik 1914 199
121. Informacion i ambasadorit Szécsen, në Paris, dërguar ministrit të Jashtëm, kontit Berchtold, në Vjenë, mbi intervistën e Esat Pashës në Paris
Paris, më 8 korrik 1914 199
122. Njoftim i Ministrisë së Luftës - Seksionit të Marinës, në Vjenë, dërguar Ministrisë së Jashtme, në lidhje me përmbajtjen e telegramit të komandës së Kastelnuovos mbi meshën ceremoniale për admiralët dhe gjithë komandantët e anijeve të huaja në bordin e "St. Georg"
Vjenë, më 8 korrik 1914 200
123. Telegram i ministrit të Jashtëm, Berchtold, dërguar Lövental-it, në Durrës, për qëndrimin e pandryshuar refuzues të Austro-Hungarisë ndaj kandidaturës së princ Ahmet Fuadit për fronin e Shqipërisë
Vjenë, më 8 korrik 1914 200
124. Telegram i Ministrisë së Jashtme, në Vjenë, dërguar ambasadorit Mérey, në Romë, që lidhur me kufirin në Tarabosh, i cili duhet të përcaktohet sipas vendimeve të Konferencës së Londrës, t'i jepen shpjegimet e nevojshme markez di San Giuliano-s
Vjenë, më 8 korrik 1914 201

125.
Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, dërguar Lövental-it, në Durrës, lidhur me ndihmat për refugjatët
Vjenë, më 8 korik 1914 203
126.
Telegram i ministrit austro-hungarez të akredituar në Durrës, Lövental, dërguar kontit Berchtold në Vjenë, me të cilin konfirmon marrjen dhe dërgimin në destinacion të 500 librave të leximit shqip
Durrës, më 8 korrik 1914 203
127.
Njoftim i Seksionit të Marinës për Ministrinë e Mbrojtjes, me të cilin e informon se Ahmet Zogolli u dorëzoi Krujën kryengritësve, pa bërë luftë
Vjenë, më 8 korrik 1914 204
128.
Raport i konsullit Halla, në Shkodër, dërguar kontit Berchtold, në Vjenë, lidhur me ngjarjet e datës 7 korrik, kur disa persona që tentuan të bëjnë kontrabandë duhani, u përplasen me xhandarmërinë e policinë
Shkodër, më 8 korrik 1914 204
129.
Korrespondencë e shefit të Shtabit të Ushtrisë austro-hungareze, Conrad, me ministrin e Jashtëm Berchtold, në Vjenë, mbi misionin e oficerëve për Shqipërinë, ku i kërkon që të ndikojë urgjentisht në dërgimin e misionit të oficerëve austro-hungarezë
8 korrik 1914 206
130.
Telegram i ministrit të Jashtëm austro-hungarez, Berchtold, në Vjenë, dërguar ambasadorit Mérey, në Romë, lidhur me ngjarjet në Korçë
Vjenë, më 8 korrik 1914 207
131.
